



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:159299
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06206073

C-III.-12-1753

Paditësi:

1.I Rr M– nga Malisheva, përfaqësuar nga **av. T B**, Gjakovë

Kundër

E paditura:

1.NSh “Mirusha” – Malishevë, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55, Prishtinë,

2. Komuna e Malishevës – Malishevë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga kryesuesja e kolegjit Hajrie Shala gjyqtare dhe anëtarët e kolegjit Ganimete Puka dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.17 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit I Rr M.

2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi ka parashtruar padi për vërtetim e së drejtës pronësore lidhur me ngastrën kadastrale nr. , në vendin e quajtur “S -L ” në sipërfaqe prej 0.08.74, fletaposeduese nr.. ZK Malishevë, e cila tani gjendet e evidentuar në emër të NB Mirushës, si pjesë e ngastrave nr. .. fletaposeduese nr.. ZK Malishevë.

Paditësi ka theksuar gjatë viteve 1959 deri 1967 ngastra e kërkuar, në mënyrë të gabuar dhe në mungesë të vullnetit të paraardhësit të paditësit e duke përdorur presion fizik dhe politik, për familjen dhe pasurinë e tij, ja morri ngastrën dhe e barti në mungesë të bazës ligjore për fitimin e pronësisë, në pronën shoqërore, fillimisht në qeverijse te OP “Përparimi” – Malishevë, e më pastaj në tituj të ndryshëm shfrytëzues e për tu gjindur tani në emër të NB Mirusha si pjesë e ngastrave nr.. fletëposedimi nr. .ZK Malishevë.

Paditësit propozojnë që të vërtetohet se paditësi nga baza juridike e trashëgimisë nga paraardhësi i tij është pronar, si dhe të detyrohet NB “Mirusha” dhe Komuna e Malishevës te ja njohin këtë të drejtë.

Në seancën e mbajtur me 17 shtator 2024, përfaqësuesi i paditësit av. T B deklaroi se është paisur me certifikatën e vdekjes të paditësit dhe se ai ka vdekur me 09.12.2004. Në bazë të kësaj informate shihet se padia në Gjykatën Komunale në Malishevë është parashtruar në vitin 2007 që i bie pas vdekjes së tash të ndjerit I Rr M. I njëjti i propozoi gjykatës që të ndërpres procedurën në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit I Rr M.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse, sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë.”*

Përkundër faktit se Gjykata caktoi dy seanca, duke i dhënë mundësin djalit të paditësit që të vërtetoi se është trashëgimtar ligjor i paditësit tani të ndjer, i njëjti nuk e dorëzoi vendimin e trashëgimisë për të vazhduar procedurën andaj, gjykata pas shqyrtimit ndërpreu procedurën, deri në një kërkesë për vazhdim të saj.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Ganimete Puka, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtar